



Pranimaz Datozuar Prindesa/Prishta Prizren/Dobrojevi	08 . 11 . 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No	Shtopi e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SJKK	6915/2022		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.832/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti - Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.832/2022 të datës 29.09.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.832/2022 e datës 29.09.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.27/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.

III. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës *Administratore* pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 29.09.2022 ka parashtruar

ankesë me numër protokoli 5746/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.832/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.27/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 03.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 26.10.2022, ka dërguar përgjigjen në ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5746/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.832/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.10.2022 si dhe kërkesën për përgjigje në ankesë përmes e-mailit zyrtar të datës 26.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.10.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me numër KA.nr.27/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Ankesën e ankueses Nr.01/1594 të datës 16.08.2022 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Akt Emërimit e ankueses Nr.03 referencë 112-606 të datës 28.12.2012; Kontratën e Punës për kohë të caktuar, Nr.01/1089 të datës 29.07.2022, të ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar dhe se çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja sipas Aktit të Emërimit me numër reference 112-606 të datës 28.12.2012 ishte emëruar si nëpunëse civile e karrierës (me afat të pacaktuar) në pozite e punës *Administratore* pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë. E njëjta, në këtë pozitë të punës ishte emëruar duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 paragrafi 1 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 29.07.2022, ankueses i kishte ofruar për nënshkrim *Kontratë Pune për kohë të caktuar* për pozitën e njëjtë të punës *Administratore* në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, por që tani e njëjta duhej t'i nënshtrohet dispozitave të Ligjit të Punës.

Kundër Kontratës së Punës për kohë të caktuara, të datës 29.07.2022, ankuesja kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendimin ankimor se ndryshimi i statusit të marrëdhënies së punës nga statusi i nëpunësit civil të karrierës me Akt Emërim të përhershëm në statusin e të punësuarit me Kontratë Pune me afat të caktuar dhe që i nënshtrohet dispozitave të Ligjit të Punës, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 3 paragrafi 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që marrëdhënia e punës e stafit të Gjykatave i

nënshtrohet dispozitave të këtij ligji dhe rrjedhimisht marrëdhënia e tyre e punës është e karrierës – pa afat të caktuar.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me Vendimin KA.nr.27/2022 të datës 29.08.2022, ka shpallur veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e datës 29.07.2022 të parashtruar nga ankuesja me arsyetimin se Rregullorja Nr.04/2022 për Procedurat e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit të Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, gjegjësisht neni 27, paragrafi 1. Parashihet se: *Kandidati i suksesshmen pas përzgjedhjes nga Këshilli, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës, me Këshillin lidhe kontrate të punës me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre si pale punëdhënës dhe punëmarrës, ndërsa ne dispozitat kalimtare gjegjësisht në nenin 32 paragrafi 1 përcaktohet se: Me se largu ne afat prej 30 ditëve pas hyrjes ne fuqi të kësaj rregullore, ne pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe ketë rregullore, akt-emërimi i administratorit aktual të gjykatës përkatëse nga Këshilli do të zëvendësohet me kontrate të rregullt pune me afat të caktuar prej pesë (5) vite.* Tutje ky organ i shqyrtimit të ankesave konstaton se pozita e ankueses tani e tutje nuk gëzon statusin e shërbyesit civil dhe marrëdhënia e saj e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave vendos vetëm lidhur me zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në Shërbimin Civil.

Kundër Vendimit KA.nr.27/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit Gjyqësor të Kosovës, ankuesja me datë 29.09.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në mënyrë tërësisht të pa bazuar në ligj dhe pa i shqyrtuar faktet dhe pretendimet ankimore të ankueses ka shpallur veten jo kompetent. Me tutje e njëjta pretendon se organi i shkalles se parë nuk ka marr parasysh faktin se ankesa e parashtruar i referohet shkeljeve të drejtave të punës në cilësinë e Zyrtarit të Shërbimit Civil të Kosovës. Ankuesja, edhe në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se ndryshimi i statusit të marrëdhënies së punës nga statusi i nëpunësit civil të karrierës me Akt Emërim të përhershëm në statusin e të punësuarit me Kontratë pune me afat të caktuar dhe që i nënshtrohet dispozitave të Ligjit të Punës, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 3 paragrafi 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës. Rrjedhimisht, e njëjta kërkon që ankesa e saj e parashtruar me datë 29.09.2022 të aprovohet në tersi si e bazuar dhe të anulohet Vendimi KA.nr.27/2022 i datës 29.08.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, si dhe Kontrata e Punës për kohë të caktuar e datës 29.07.2022, ndërsa kërkon që të mbetet në fuqi Akti i Emërimit me numër reference 112-606 të datës 28.12.2012.

Kolegji i Këshillit, në këtë çështje ankimore fillimisht analizoi dispozitat ligjore me të cilat përcaktohet kompetenca lëndore e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*



Rrjedhimisht, lidhur me këtë çështje, Kolegji i Këshillit ju referuar edhe Aktgjykimit në rastin KO171/2019 të datës 20 maj 2019 të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht paragrafit 98 ku përcaktohet se: ... e drejta për të nxjerr një ligj të posaçëm për rregullimin e shërbimit civil në Republikën e Kosovës, buron nga paragrafi 1 i nenit 101 të Kushtetutës, ndërsa e drejta për të nxjerr një ligj të posaçëm për Këshillin buron nga paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, ndërsa me paragrafin 99 të këtij aktgjykimi përcaktohet se: ... paragrafi 2 i nenit 101 ndërlidhet ngushtë dhe është derivat i paragrafit 1, i cili në mënyrë specifike kërkon që zbatimi i normave juridike që rregullojnë shërbimin civil do të mbikëqyret nga një "këshill i pavarur mbikëqyrës".

Kolegji i Këshillit, pas konstatimit lidhur me ekzistimin e kompetencës lëndore ka analizuar aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimin KA.nr.27/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe rrjedhimisht vlerësojë se i njëjti përmban të meta esenciale që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit. Kjo për faktin se sipas vlerësimit të Kolegjit të Këshillit, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vendosur duke pasur paqartësi të theksuara në kompetencën e tij, dhe kryesisht duke u bazuar vetëm në Rregulloren Nr.04/2022 për Procedurat e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit të Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, por që marrja e vendimit vetëm mbi këtë bazë bie ndesh me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 81 përcaktohet se: 1. *Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë.* 2. *Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës,* ndërsa me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 134 paragrafi 1 përcaktohet se: 1. *Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.*

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.27/2022 të datës 29.08.2022, me të cilin ka shpallur veten jo kompetent për vendosje i është referuar vetëm statusit aktual të marrëdhënies së punës të ankueses, dhe fare nuk ka marr parasysh pretendimet kryesore të palës ankuese e të cilat pretendime rrjedhin nga statuti i saj si nëpunëse civile dhe ndërlidhen drejtpërdrejtë me ndryshimin e statusit të marrëdhënies së punës nga statusi i nëpunësit civil të karrierës me Akt Emërim të përhershëm në statusin e të punësuarit me Kontratë Pune me afat të caktuar dhe që i nënshtrohet dispozitave të Ligjit të Punës.

Nga analizimi i vendimit të goditur me ankesë del se i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij ndër tjera theksohet se: *Ankuesja... ka ushtruar ankesë kundër Kontratës së Punës me afat të caktuar, të nënshkruar nga Administratoret e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës..., Me tutje theksohet se: Nga ajo që u tha me lartë, në bazë të shkresave të lëndës, gjendjes faktike dhe dispozitave të sipër cekura, del se pozita e ankueses, tani e tutje nuk e gëzon statusin e shërbyesit civil, dhe marrëdhënia e saj rregullohet*

me Ligjin e Punës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave vendos vetëm lidhur me zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil, andaj një arsyetim i tillë në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.5, si dhe neni 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse i njëjti nuk përmban paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës dhe shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, dhe po ashtu vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë, për faktin se nga administrimi i shkresave të lëndës del se ankuesja nuk është ankuar në lidhje me të drejtat e saj që rrjedhin nga statusit aktual i punës, por pretendimet ankimore janë parashtruar drejtpërdrejtë në lidhje me ndryshimin e statusit të marrëdhënies së punës nga statusi i nëpunësit civil të karrierës me Akt Emërim të përherëshëm në statusin e të punësuarit me Kontratë Pune me afat të caktuar. Se vendimi i kontestuar është kontradiktor shihet edhe nga fakti se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në njërin anë ka vendosur të shpall veten jo kompetent për vendosje duke marr për bazë statusin aktual të ankueses, ndërsa në anën tjetër ankuesen e udhëzon për ushtrimin e mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, institucion ky përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me ankesat e parashtruara nga nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses kishte parasysh Aktgjykimin në rastin KO203/19 të datës 9 korrik 2020 të Gjykatës Kushtetuese me të cilin është konstatuar se neni 2 paragrafi 3 (fusha e zbatimit) dhe neni 85 i Ligjit Nr.06/114 për Zyrtaret Publikë nuk janë në pajtueshmëri me nenin 108 (Këshilli Gjyqësor i Kosovës) të Kushtetutës, dhe si rrjedhojë në kuptim të fushës së zbatimit gjegjësisht përkufizimit të shërbimit civil për sistemin gjyqësor ka mbetur në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 6 përcaktohet se: *Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, me përjashtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve*, ndërsa me rregullat e legjislacionit përkatës (të veçantë), respektivisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, neni 29 paragrafi 1 përcaktohet se: *Administratori i gjykatës zgjidhet dhe shkarkohet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, në një proces të hapur dhe konkurrues, pas shpalljes publike të pozitës*, derisa me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përcaktohet se: *Këshilli në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil realizon procedurat e rekrutimit dhe të mbikëqyrjes së Administratorëve të gjykatave*.

Mirëpo, duke qenë se Vendimi i atakuar me numër KA.nr.27/2022 i datës 29.08.2022, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që kjo çështja ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj ankesën e ankueses dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit.



Keshtu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËSOR PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.832/2022.

Ilire Mehmeti - Shaqiri


Procesmbajtëse

Jeton Koca


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.